

LIGJ
Nr. 4/2020

**PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARIVE
FINANCIARE¹**

(ndryshuar me ligjin nr. 109/2020, datë 29.7.2020)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me:

- a) shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare, në zbatim të standardit të përbashkët të raportimit dhe marrëveshjes shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare;
- b) detyrimin e institucioneve financiare raportuese për mbledhjen dhe raportimin e informacioneve të caktuara financiare pranë Autoritetit Kompetent, në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit;
- c) përcaktimin e termave dhe të kushteve të përgjithshme, që lidhen me grumbullimin, përpunimin, përditësimin, bashkëveprimin, përjasjen, ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e informacionit, në lidhje me shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare në çështjet tatimore;
- ç) të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kompetent për të siguruar zbatimin efektiv dhe përputhshmërinë me Standardin e Përbashkët të Raportimit, duke përfshirë marrjen dhe përdorimin e informacionit.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj synon sigurimin e zbatimit të Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështje Tatimore, të marrëveshjes shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare, për shmangien e mashtrimit tatimor dhe të evazionit fiskal, si dhe përmirësimin e pajtueshmërisë tatimore kombëtare e ndërkombëtare.

Neni 3

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2011/16/BE, datë 15 shkurt 2011, "Mbi bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve dhe shfuqizimin e Direktivës 77/799/KEE", të ndryshuar. Numri CELEX 32011L0016, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.64, datë 11.3.2011, faqe 1-12.

Parim i përgjithshëm

Shkëmbimi automatik i informacionit të llogarive financiare bëhet duke zbatuar dispozitat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

Neni 4 Subjektet

Subjekte të këtij ligji janë institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë, që ngarkohen për raportimin e llogarive të raportueshme, të mbajtura nga persona të raportueshëm, sipas dispozitave të vendosura në këtë ligj.

Neni 5 Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) “Autoriteti Kompetent” është administrata tatimore, e ngarkuar nga ky ligj për mbledhjen e informacionit nga institucionet financiare raportuese dhe për shkëmbimin automatik me juridiksionet e tjera, në përputhje me marrëveshjen shumëpalëshe në këtë fushë;
 - b) “Institucion financiar në Republikën e Shqipërisë”, është:
 - i. çdo institucion financiar rezident në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të çdo dege të atij institucioni financiar, që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - ii. çdo degë e një institucioni financiar jorezident në Republikën e Shqipërisë, nëse kjo degë është e vendosur në Republikën e Shqipërisë;
 - iii. çdo institucion kujdestarie, institucion depozitues, shoqëritë e investimit ose një kompani e specifikuar sigurimi, sipas përcaktimeve të Standardit të Përbashkët të Raportimit;
 - c) “Institucioni financiar raportues” është çdo institucion financiar në Republikën e Shqipërisë që ka detyrimin të raportojë veprimtarinë financiare të klientëve pranë administratës tatimore;
 - ç) “Juridiksion i raportueshëm” është një juridiksion i identifikuar në listën e publikuar, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e këtij ligji;
 - d) “Llogari e raportueshme” është një llogari e mbajtur nga institucioni financiar raportues, e cila, sipas procedurave të vigjilencës së duhur, në përputhje me Standardet e Përbashkëta të Raportimit, është identifikuar si një llogari që mbahet nga një ose më shumë persona të raportueshëm në lidhje me juridiksionin tjetër ose nga një njësi ekonomike jofinanciare pasive, me një ose shumë persona kontrollues, të cilët konsiderohen persona të raportueshëm në lidhje me juridiksionin tjetër;
 - dh) “Marrëveshje” është marrëveshja shumëpalëshe e Autoritetit Kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare, e miratuar me vendimin nr. 178, datë 9.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes shumëpalëshe, të Autoritetit Kompetent, për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare”;
 - e) “Ofruesi i shërbimit palë e tretë” është personi, i cili mbledh, mban dhe raporton tek Autoriteti Kompetent informacionin e llogarive të raportueshme për një institucion financiar raportues;
 - ë) “Person i raportueshëm” është një individ ose njësi ekonomike, që është identifikuar si i/e tillë nga një institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë, rezident i një juridiksioni tjetër, sipas procedurave të vigjilencës së duhur, në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit;
 - f) “Standard i Përbashkët i Raportimit” është standardi i vendosur nga Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) për informacionin që do të raportohet nga

institucionet financiare dhe që do të shkëmbehet me juridiksionet përkatëse, në të cilin përfshihet dhe Komentari;

g) “Vigjilenca e duhur” janë procedurat e përcaktuara për të identifikuar llogaritë e raportueshme, që mbahen nga personat e raportueshëm;

gj) “Komentari” është interpretim i detajuar i çdo seksioni të Marrëveshjes së Autoritetit Kompetent dhe Standardit të Përbashkët të Raportimit, që synon të sigurojë zbatimin e duhur të tyre në të gjitha juridiksionet, si dhe të shmangë krijimin e kostove të panevojshme për institucionet financiare, veçanërisht për ato institucione që i përkasin më shumë se një juridiksioni.

2. Çdo term tjetër, i përcaktuar ndryshe në këtë ligj ose në vendimin e Këshillit të Ministrave të nxjerrë në zbatim të tij, do të ketë kuptimin që ai ka në atë moment, sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në përputhje me kuptimin e përcaktuar në Standardin e Përbashkët të Raportimit.

KREU II DETYRIMI PËR RAPORTIM

Neni 6

Raportimi tek Autoriteti Kompetent

1. Çdo institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë i raporton Autoritetit Kompetent informacionin mbi llogaritë e raportueshme vjetore, të specifikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda datës 30 maj të vitit vijues, për të cilin mbledhet informacioni, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji.

2. Nëse institucioni financiar raportues, pas aplikimit të procedurave të vigjilencës së duhur, të përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji, për një vit kalendarik nuk identifikon asnjë llogari si llogari të raportueshme, dërgon brenda afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, pranë Autoritetit Kompetent, një deklaratë, e cila konfirmon mospasjen e një llogarie të raportueshme për vitin raportues.

3. Informacioni duhet të dërgohet elektronikisht, sipas një formati të standardizuar, duke përdorur teknologjinë e përshtatshme, në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 7

Vigjilenca e duhur

1. Për qëllim të nenit 6, të këtij ligji, institucionet financiare raportuese në Shqipëri duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e vigjilencës së duhur, të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, përfshirë edhe mbledhjen e vetëdeklarimeve për të gjitha llogaritë financiare të raportueshme, subjekte të këtij ligji.

2. Institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë kanë detyrimin të informojnë mbajtësit e llogarive të raportueshme për përpunimin e të dhënave të tyre personale, në kuadër të procesit të vigjilencës së duhur dhe detyrimit të raportimit, të kryer në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, përpara fillimit të procesit të raportimit dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 8

Ndarja e informacionit brenda të njëjtit grup ose me ofruesit e shërbimit palë e tretë

1. Institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë mund të ndajnë me ofruesit e shërbimeve, palë e tretë, ose me institucione të tjera financiare, që janë pjesë e të njëjtit grup, dokumentacionin dhe informacionet e mbledhura në lidhje me mbajtësit e llogarive të

raportueshme, me qëllim përmbushjen e mbledhjes së të dhënave, të raportimit dhe rregullave për vigjilencën e duhur, të parashikuara nga nenet 6 dhe 7, të këtij ligji.

2. Ofruesit e shërbimit, palë e tretë, që mbajnë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për të bërë të mundur mbledhjen e të dhënave, procedurën e vigjilencës së duhur dhe detyrimet e raportimit, të përmendura nga nenet 6 e 7, të këtij ligji, mundet që, për qëllime të pajtueshmërisë së institucioneve të tilla financiare me detyrimet e lartpërmendura, të ndajnë informacionin dhe dokumentacionin përkatës që disponojnë me institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë.

3. Institucioni financiar raportues është përgjegjës për raportimin dhe zbatimin e rregullave të vigjilencës së duhur, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 9

Detyrat dhe kompetencat e Autoritetit Kompetent

1. Autoriteti Kompetent, nëpërmjet strukturave të tij të varësisë, mund të kërkojë informacion, nga çdo institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë. Me lajmërim paraprak, ai mund të hyjë në ambientet ku ushtrohet veprimtaria ekonomike e tij, me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimit të përcaktuar me këtë ligj.

2. Brenda 15 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës me shkrim të Autoritetit Kompetent, institucioni financiar raportues i vë në dispozicion regjistrimet apo të dhënat e mbajtura, sipas nenit 10, të këtij ligji, si dhe çdo dokument tjetër që kërkohet për të kryer verifikimin e përmbushjes së detyrimit të përcaktuar me këtë ligj.

3. Me kërkesë të autoritetit kompetent, një institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë duhet të japë shpjegime shtesë. Informacioni shtesë, veç detyrimeve të tjera, përmban:

a) plotësimin, nënshkrimin dhe kthimin e pyetësorëve ose kërkesave të tjera me shkrim për informacion nga Autoriteti Kompetent brenda 15 ditëve pune, nga data e marrjes së kërkesës;

b) takimin me punonjësit e Autoritetit Kompetent gjatë orarit të punës, dhënien e përgjigjeve për pyetjet e adresuara, si dhe të informacionit lidhur me zbatimin e këtij ligji.

4. Autoriteti Kompetent mund të njoftojë institucionin financiar kur ka arsye të besojë se një gabim mund të ketë çuar në informacione të pasakta ose të paplota, apo nëse raportimi nuk është në pajtim me kërkesat e zbatueshme dhe procedurat e vigjilencës së duhur, në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit.

Neni 10

Mbajtja e të dhënave dhe detyrimi për ruajtjen e tyre

1. Institucioni financiar raportues në Republikën e Shqipërisë duhet të krijojë, të mbajë dhe të dokumentojë procedurat e vigjilencës së duhur, në zbatim të këtij ligji, të cilat janë hartuar për të identifikuar llogaritë e raportueshme të mbajtura nga institucione të tilla financiare.

2. Institucioni financiar raportues:

a) mban regjistrimet që institucioni merr ose krijon, me qëllim përmbushjen e Standardit të Përbashkët të Raportimit, rregullave dhe procedurave, përfshirë vetëdeklarimet, hapat e ndërmarrë për identifikimin e llogarive të raportueshme dhe të dëshmive të dokumentuara. Të dhëna të tilla mbahen në formë elektronike ose dokument letër;

b) i mban këto të dhëna për një periudhë prej, të paktën, pesë vitesh, pas përfundimit të periudhës brenda së cilës institucioni duhet të raportojë informacionin e kërkuar për raportim, sipas Standardit të Përbashkët të Raportimit. Me përfundimin e këtij afati këto të dhëna shkatërrohen;

c) merr masat e nevojshme teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e të dhënave personale, që përpunohen në kuadër të këtij ligji.

3. Nëse këto regjistrime mbahen në një gjuhë tjetër, përveç asaj shqipe, në bazë të kërkesës së Autoritetit Kompetent, institucioni financiar raportues në Republikën e Shqipërisë duhet të sigurojë përkthim të tyre në gjuhën shqipe.

Neni 11

Shkëmbimi i informacionit mbi llogaritë e raportueshme

(shtuar pika 2 me ligjin nr. 109/2020, datë 29.7.2020)

1. Në përputhje me dispozitat e Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore, si dhe bazuar në rregullat e raportimit dhe të vigjilencës së duhur, në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, Autoriteti Kompetent shkëmben, me juridiksione të tjera kompetente, brenda 9-mujorit të çdo viti dhe në mënyrë automatike, informacionet e marra në bazë të procedurave dhe rregullave të specifikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Përgjithësisht për shkëmbimin e parë automatik, autoriteti kompetent shkëmben informacion me juridiksionet e tjera kompetente brenda datës 31.12.2020.

KREU III

SANKSIONET DHE ANKIMI ADMINISTRATIV

Neni 12

Kundërvajtjet administrative

1. Veprimet ose mosveprimet e kryera nga institucionet financiare raportuese apo persona të tjerë përgjegjës, të cilat janë në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) mosdorëzimi në afat i informacionit të detyrueshëm për t'u raportuar, i përcaktuar sipas këtij ligji, 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

b) dorëzimi i pasaktë i informacionit të detyrueshëm për t'u raportuar, jo në përputhje me nevojën dhe formën e përcaktuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

c) mosdhënia e informacionit të kërkuar nga çdo mbajtës i llogarive të raportueshme ose person tjetër përgjegjës, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, përveç nëse ky informacion ka të bëjë me një person të tretë dhe provohet se mosveprimi nuk ishte i qëllimshëm, dënohet me 1 000 000 (një milion) lekë gjobë;

ç) kryerja e deklarimit të rremë nga çdo mbajtës i llogarive të raportueshme ose person tjetër përgjegjës, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, dënohet me 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë gjobë;

d) pengimi nga personat përgjegjës, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me qëllim mosushtrimin e të drejtave dhe detyrave të Autoritetit Kompetent, të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, dënohet me 1 000 000 (një milion) lekë gjobë;

dh) zbatimi në mënyrë të gabuar i rregullave të vendosura mbi vigjilencën e duhur, si pasojë e neglizhencës nga personi që ka për detyrë t'i zbatojë ato dënohet me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë;

e) kryerja me dashje e veprimeve në kundërshtim me rregullat e vendosura mbi vigjilencën e duhur, nga subjektet përgjegjëse, dënohet me 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë gjobë.

2. Për raste të tjera kundërvajtjesh administrative, të paparashikuara në këtë ligj, zbatohen dispozitat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13
Ankimi

Subjektet e këtij ligji kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit apo veprimit të Autoriteti Kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14
Rregulli kundër shmangies

Institucioni financiar, ndërmjetësi, ofruesi i shërbimit apo çdo person tjetër, që hyn në një marrëveshje ose angazhohet në një praktikë, që synon të shmangë apo anashkalojë detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, konsiderohet subjekt i këtyre detyrimeve, pavarësisht marrëveshjes së lidhur apo angazhimit në këtë praktikë.

KREU IV
KONFIDENCIALITETI DHE SIGURIMI I TË DHËNAVE

Neni 15
Konfidencialiteti

1. Informacioni i siguruar nga institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë është konfidencial.

2. Çdo punonjës i Autoritetit Kompetent, institucionit financiar raportues dhe çdo funksionar publik, që ka akses në të dhënat personale që përpunohen në kuadër të këtij ligji, ka detyrimin që të nënshkruajë deklaratën e konfidencialitetit, e cila administrohet nga institucionet përkatëse, në cilësinë e punëdhënësit.

3. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pasi zyrtarët ose punonjësit nuk janë më të punësuar nga Autoriteti Kompetent, institucioni financiar raportues apo institucioni përkatës.

4. Informacioni i marrë nga autoritetet kompetente të huaja duhet të mbahet konfidencial, në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit dhe legjislacionin vendas.

Neni 16
Siguria e të dhënave

Përpunimi i të dhënave personale, në kuadër të procesit të shkëmbimit automatik të informacionit të llogarive financiare për çështje tatimore, kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 17
Interpretimi

Dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij interpretohen në përputhje me Komentarin e Standardit të Përbashkët të Raportimit.

Neni 18
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7, 8, 11, 12 dhe 14, të këtij ligji, jo më vonë se 3 muaj nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 19

Dispozita kalimtare

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 109/2020, datë 29.7.2020)

1. Përjashtimisht për raportimin e parë, institucioni financiar raportues, pas aplikimit të procedurave të vigjilencës së duhur, raporton brenda datës 15 nëntor 2020 për të gjitha llogaritë e raportueshme ekzistuese në datën 1.1.2019, si dhe llogaritë e raportueshme të hapura përgjatë vitit 2019, sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.

2. Për raportimet në vitet pasuese, institucioni financiar raportues raporton pranë administratës tatimore brenda datës 30 maj, për llogaritë e raportueshme të vitit kalendarik paraardhës.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 30.1.2020.